



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

**AKT PËRCJELLËS**

Për:	<ul style="list-style-type: none"><li>Zyrtari përgjegjës i prokurimit, <b>KOMUNA E PODUJEVËS</b></li></ul> <u>Operatori Ekonomik ankues:</u> <ul style="list-style-type: none"><li>Grupi i Operatorëve ekonomik “PMC” SH.P.K. &amp; N.T.P. “Adri Zaun- Rrethoja”, Ulpianë, 10000, Prishtinë</li></ul>	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
Prej:	<b>Shefkinaze Vllasaj</b> – Ekspert shqyrtues i prokurimit		
Lënda:	<b>Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën me nr. 289/19 të parashtruar nga tenderuesi, Grupi i Operatorëve ekonomik “PMC” SH.P.K. &amp; N.T.P. “Adri Zaun- Rrethoja”, Ulpianë, 10000, Prishtinë</b>		
Datë	20.06.2019		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, ju njoftojmë me raportin, lidhur me ankesën e dt: 07.06.2019 me nr. 289/19 të parashtruar nga tenderuesi, Grupi i Operatorëve ekonomik “PMC” SH.P.K. & N.T.P. “Adri Zaun- Rrethoja”, lidhur me aktivitetin prokurimit,

Titulli: Ndërtimi i serave për fermer me nr. të prokurimit: **615-19-942-5-2-1** dhe Numri i brendshëm: 615-19-011-521i iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PODUJEVËS.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur me këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

**Ti dorëzohet:**

- Autoritetit Kontraktues – KOMUNA E PODUJEVËS
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- Grupi i Operatorëve ekonomik “PMC” SH.P.K. & N.T.P. “Adri Zaun- Rrethoja”, Ulpianë, 10000, Prishtinë,



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

**RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES**

		<b>10.06.2019</b>	<b>17.06.2019</b>
<i>Nënshkrimi i ekspertit</i>		<i>data e autorizimit të ekspertit.</i>	<i>data e dorëzimit të raportit</i>

***N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit***

1) Me datën: 07.06.2019 tenderuesi Grupi i Operatorëve ekonomik “PMC”SH.P.K. & N.T.P. “Adri Zaun- Rrethoja”, ka parashtruar ankesë në OSHP, kundër njoftimit për Vendimin e Autoritetit Kontraktues, lidhur me aktivitetin e prokurimit “NDËRTIMI I SERAVE PËR FERMER ”, me nr. të prokurimit: 615-19-942-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues(AK) – KOMUNA E PODUJEVËS. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të Tenderuesit ankues.

**Tenderuesi Ankues,** Grupi i Operatorëve ekonomik “PMC”SH.P.K. & N.T.P. “Adri Zaun- Rrethoja”, Ulpianë, 10000, Prishtinë

Dispozitat e shkelura sipas tenderuesit ankues Grupi i Operatorëve ekonomik “PMC”SH.P.K. & N.T.P. “Adri Zaun- Rrethoja”, Ulpianë, 10000, Prishtinë, janë:

Pretendojmë se AK-Komuna e Podujevës përmes Komisionit për vlerësimin, krahasimin dhe ekzaminimin e tenderit gjatë procedurës së vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderit ka bërë shkelje të dispozitave të;

I- Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, (më tekstin e mëtejme do të i referohemi LPP-së dhe atë) konkretisht:

Nenit 7, Barazia në trajtim/Jo diskriminimi

Neni 56, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave,



Neni 59, Vlerësimi ekzaminimi dhe krahasimi,

Neni 60, Kriteret pre Dhënien e Kontratës

II-Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik

Neni 41, Vlerësimi ekzaminimi dhe krahasimi

#### DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET:

Në vazhdim të kësaj ankese do të përpiqemi që të argumentojmë shkeljet e pretenduara të:

1. Të dispozitave të LPP-se në RK.

##### ➤ Nenit 7, Barazia në trajtim/Jo diskriminimi

Rekomandimi i Komisionit për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit që, tenderi i OE; NTP" Liria" të shpërblehet me kontratë është në kundërshtim me nenin 7 të LPP- së në RK, duke favorizuar ofertën e këtij operatori dhe duke diskriminuar operatorët tjerë pjesëmarrës në tender.

Pabarazia në trajtim si dhe favorizimi i një operatori si dhe diskriminimi i operatorëve tjerë është bere nga ana e AK në procedurën e kualifikimit dhe përzgjedhjes së OE dhe me rastin e shpërblimit të kontratës. Ligji parasheh obligimin e çdo Autoritet kontraktues që gjatë zhvillimit të procedurës së vlerësimit ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve të i trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminues dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

##### ➤ Neni 56, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

Pretendojmë se Komisioni për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit ka vepruar në kundërshtim me neni 56, paragrafin 1.1 dhe paragrafi 1.2 të LPP-se në Republikën e Kosovës.

Në vijim po citoj dispozitat e nenit 56. paragrafi 1.1 dhe 1.2 të këtij ligji,

Të gjitha kontratat publike do të jepen, sipas procedurave të themeluara për një seleksionim të tillë, dhe përmes:

1.1. së pari, vlerësimit të tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit sipas paragrafit 2. të nenit 51 të këtij ligji, dhe tenderëve sipas specifikimeve teknike të kërkuara në bazë të nenit 28 të këtij ligji;

1.2. së dyti, vlerësimi tenderëve në përputhshmëri të kriterëve të vendosura në nenin 60 të këtij ligji

Duke u bazuar në Kërkesat formale administrative të pjesëmarrjes në tender , të përcaktuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë si dhe në dispozitat e nenit 56 paragrafi 1.1 dhe 1.2 të LPP-se, si dhe bazuar në dëshmitë të dorëzuara nga OE NTP " Liria" pretendojmë se AK-KK Podujeve përmes Komisionit për vlerësimin ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit ka vepruar në kundërshtim me nenin 56 paragrafi 1.1 dhe 1.2 të LPP-se.



➤ **Neni 59, Vlerësimi ekzaminimi dhe krahasimi,**

Pretendojmë se Komisioni për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit me vendimin e vet për të shpërblyer me kontratë ofertën e OF NTP " Liria" ka vepruar në kundërshtim me neni 59 , paragrafin 2, dhe 4 të LPP-se në Republikën e Kosovës.

Në vijim po citoj dispozitat e nenit 59. paragrafi 2 dhe 4 të këtij ligji:

2. *Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkojen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues.*
4. *Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmeja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.*

Duke u bazuar në Kërkesat formale administrative të pjesëmarrjes në tender të përcaktuara në paragrafin 8.1 & 8.2 - Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare si dhe në paragrafin 9.1 & 9.2 ~ Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të Njoftimit për kontratë dhe në Dosjen e tenderit si dhe bazuar në dispozitën e nenit 59 paragrafi 2 dhe 4 të LPP-së si dhe në dëshmitë e dokumentuara të OE të propozuar për kontratë NTP " Liria " shohim se AK; KK Podujevë ka bërë vlerësimin ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit në kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit dhe në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së.

Në vijim të kësaj ankese do të përpiqemi që të i argumentojmë pretendimet ankimore :

1. **AK në Njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit në paragrafin; 8.1& 8.2 ka kërkuar:**

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	Kapaciteti ekonomik dhe financiar:  OE duhet të ofroj dëshmi të mjaftueshme AK se qarkullimi vjetor i OE gjatë tre viteve të fundit ka qenë jo më pak se 320,000.00euro.	Dëshmia e kërkuar dokumentare:  Sipas nenit 68 pika 1.5, deklaratat tatimore vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës
--	-----------	--	--

Duke u bazuar në dëshmitë e pranuar në kopje me rastin e qasjes në dokumentet e publike të fituesit të propozuar për kontratë NTP" Liria " dëshmi të dokumentuar, ka ofruar nga ATK- ja ; Dëshmi mbi Gjendjen e përgjithshme të deklarimeve dhe transaksioneve tjera për vitin 2012 deri me 2018 si dhe Formularët e Deklarimit në TVSH për vitin 2018, ndërkaq AK ka kërkuar nga OE që për tu kualifikuar OE duhet të plotësojnë; Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare përkatësisht të dëshmojnë se qarkullimi vjetor i OE gjatë tre viteve të fundit ka qenë jo më pak se 320,000.00euro, duke e dëshmuar me **Deklaratat**



**Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës.**

**Prove: Kopjet e dëshmime të OE; NTP " Iliria"**

Duke pasur parasysh këto fakte pretendojmë se OE i propozuar për shpërblim të kontratës nuk e ka plotësuar kërkesën e AK-së përkitazi me plotësimin e kërkesave mbi gjendjen ekonomike dhe financiare përkatësisht nuk ka ofruar dëshmi kon formë kërkesës së AK-se nga ATK-ja ; **Deklaratat tatimore vjetore për tri vitet e fundit dhe mbi këtë bazë AK gjatë procedurës së parazgjedhjes së pjesëmarrësve ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 paragrafi 2 dhe paragrafi 4 të LPP-së.**

2. AK ne Njoftimin për kontrate dhe ne dosjen e tenderit ne FDT te dosjes se tenderit ne paragrafin; 9.1 & 9.2 ka kërkuar:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	<b>Kapaciteti teknik dhe profesional:</b>	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare</i>
		Projektet e realizuara (të natyrës së ngjashme) në tre vitet e fundit e vërtetuar nga OE, minimumi në vlerë 240,000.00euro Në rast të grupit (konsorciumit), udhëheqësi i grupit duhet të ketë së paku 60% të shumës së kërkuar në punë të ngjashme të realizuara në tre vitet e fundit	Lista e projekteve të realizuara gjatë periudhës tre vjeçare në të cilat specifikohen të gjitha projektet e realizuara në tre vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë duke saktësuar punët e kryera, shumën e kontratës dhe vendin e kryerjes së punimeve, bashkangjitur referenca ose certifikatë ose raporte të pranimit
		OE duhet të ofroj dëshmi se mund të angazhoj staf të mjaftueshëm për realizimin e këtij projekti, minimumi 15 punëtorë.  a) një menaxher i projektit të jetë inxhinier i diplomuar ose master i ndërtimtarisë - drejtimi konstruktiv, përvoja e punës 2 vite pas diplomimit	Lista me numër të punëtorëve e nënshkruar dhe e vulosur nga OE Për stafin profesional (inxhinierë) - kopja e diplomës e noterizuar, cv-ja, kontrata e punës Nëse inxhinieri nuk është në listën e punëtorëve kërkohet marrëveshje për angazhim në këtë projekt
		Mjetet e punës të domosdoshme për realizimin e punimeve në këtë projekt	Lista e pajisjeve - mjeteve të punës që OE duhet të ketë ose të kontraktuara (me qira) të dëshmohet me kopje të librezave apo ndonjë dëshmi tjetër)

Duke u bazuar ne dëshmitë e pranuar ne kopje me rastin e qasjes ne dokumentet e publike te fituesit te propozuar për kontratë NTP " Liria " dëshmi te dokumentuar mbi plotësimin e kërkesës për mundësitë teknike dhe profesionale ka ofruar dëshmi nga Lista e kontratave mbi projektet e realizuara gjate periudhës tre vjeçare për furnizime me material te ndryshëm ndërtimor dhe pajisje për sera,



ndërkaq AK ka kërkuar nga OE qe te ofrojnë projekte te realizuar te natyrës se ngjashme ne vlere prej 240 000 euro, qe do te thotë qe OE duhet te dëshmojnë se kane përfunduar projekte te natyrës se ngjashme për punimin përkatësisht Ndërtimin e serave për fermer.

Bazuar ne dëshmitë e OE te propozuar për kontrate ne vend te dëshmimeve për "pune" ka ofruar dëshmi për "furnizime", ne vend te kërkesës për pune te ngjashme për ndërtim te serave për fermer ka ofruar dëshmi për furnizime me material te ndryshëm ndërtimor dhe për sera.

Duke pasur parasysh faktin qe AK , konform nenit 68 paragrafi, 1 te LPP-se ne dosje te tenderit dhe ne njoftimin për kontrate ka kërkuar nga OE qe përveç qarkullimit minimal financiar ne shume prej 320,000.00 euro te plotësojnë edhe një qarkullim i caktuar si minimal ne fushën specifike ( ndërtim te serave për fermer) te mbuluar me kontrata ne shume prej 240,000.00 euro. Kërkesë specifike e AK-se e caktuar me qellim qe te përzgjedhë një operator ekonomik i cili do te plotësoj kushtet minimale për kualifikim dhe përzgjedhje.

Bazuar në dëshmitë e dokumentuara të OE NTP "Liria" pretendojmë se Oferta është e papërgjegjshme në kuptim të dispozitave të LPP-se dhe si e tillë duhet të eliminohet nga aktiviteti i mëtejme i prokurimit.

Duke u bazuar në faktet e lartshënuara pretendojmë se AK Komuna e Podujevës gjatë zhvillimit të procedurës vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit me rastin e përzgjedhjes se pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratës ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 paragrafi 2 dhe 4 te LPP-së.

#### ➤ Neni 60, Kriteret për Dhënien e Kontratës

Pretendojmë se Komisioni për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit me

vendimin e vet për të shpërblyer me kontrate ofertën e OF NTP " Liria" ka vepruar në kundërshtim me neni 60 , paragrafin 1, dhe nën paragrafin 1.1 te LPP-se ne Republikën e Kosovës.

LPP ne nenin 60 paragrafi. 1.dhe nen paragrafin 1.1 përcakton:

1. *Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose:*
  - 1.1 *tenderin ë përgjegjshëm me çmimin më të ulët:*

Duke pasur parasysh faktin që AK, KK- Podujevë e ka trajtuar Ofertën e OE NTP "Liria" si të përgjegjshme edhe përkundër asaj se nuk i ka përmbushur kërkesat e përcaktuara në Njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit, si dhe duke pasur parasysh faktin që LPP në nenin 60 parasheh që; Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët, pretendojmë se AK ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 60 të LPP-së.

## II-Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik

#### ➤ Neni 41, Vlerësimi ekzaminimi dhe krahasimi

Pretendojmë se Komisioni për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit me vendimin e vet për të shpërblyer me kontrate ofertën e OE NTP "Liria" ka vepruar në kundërshtim me neni 41. Rregullave dhe UOPP.

Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik ne piken 41.percakton:

41.2 Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve do të kryhet nga AK brenda



periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh. Procesi i vlerësimit të tenderit do të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve dhe jo më vonë se 5 dite pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik 92

41.3 Parimet kryesore të procedurës së vlerësimit sipas LPP janë:

1. Tenderët duhet të plotësojnë substancialisht kërkesat formale administrative të specifikuara.
2. Tenderët duhet të jenë të pranueshëm dhe duhet të përmbushin kërkesat minimale të kualifikimit (nëse janë përcaktuar).
3. Tenderët duhet të plotësojnë substancialisht kushtet obligative teknike të specifikuara.
4. Tenderët e përgjegjshëm do të vlerësohen në bazë të kritereve të specifikuara të dhënies së kontratës.
5. Vetëm kërkesat dhe kritere e dhënies së kontratës të specifikuara në njoftim për kontratë/dosje të tenderit mund të përdoren si bazë për vlerësim.
6. Asnjë negociim nuk duhet të ndodhë në mes të autoritetit kontraktues dhe tenderuesve gjatë procedurës së vlerësimit, përveç komunikimeve që janë autorizuar saktësisht nga nenet 34 dhe 35 të LPP.
7. Megjithatë, vetëm sqarim i tenderëve mund të ndodhë pa ndonjë ndryshim të kushteve materiale ose aspekte të tenderit, përveç atyre të lejuara me nenin 59 dhe 72 të LPP-se.
8. Dhënia e kontratës do të bëhet në pajtim rigoroz me vlerësimin e kryer sipas 7 parimeve të cekura më lartë.

41.5 Tenderi konsiderohet të jetë i përgjegjshëm kur:

- a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit;
- b. është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit;
- c. është dorëzuar nga operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit.

41.6 Të qenët “në pajtueshmëri” nga aspekti administrativ dhe teknik duhet të kuptohet si përmbushje e kërkesave dhe e specifikimeve administrative dhe teknike të parashtruara në dosje të tenderit duke mos u larguar substancialisht nga ato dhe duke mos u bashkangjitur atyre kufizime.

Duke u bazuar në Raportin e vlerësimit të tenderit shohim se AK’ KK Podujeve ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e pikës 41 të Rregullave dhe UOPP.

- Tenderi është vlerësuar përtej afateve të përcaktuara 30 + 20 ditë kalendarike,
- » Nuk janë respektuar parimet kryesore të vlerësimit të tenderit,
- » Vendimi për dhënie të kontratës është bërë në kundërshtim me të qenit në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes ( më gjerësisht shih pretendimet për shkeljet e pretenduara të nenit 59 të LPP-së)
- Nuk është zhvilluar procedura Inter alies me OE të propozuar për kontratë për të sqaruar



dëshmitë lidhur me plotësimin e kërkesave për kapacitetin ekonomik-financiar ( Deklaratat Vjetore Tatimore nga ATK-ja), pastaj nuk është kërkuar nga OE që të sqaron dëshmitë lidhur me plotësimin e kërkesave mbi posedimin e kapacitetit teknik dhe profesional ( Dëshmitë për kontrata dhe referenca të natyrës specifike për “ Ndërtim të serave për fermer” ne vlerë totale të kontratave të përfunduara në shumën e kërkuar nga AK: 240,000.00 €, ( më gjerësisht shih pretendimet për shkeljet e pretenduara të nenit 59 të LPP-së)

- Nuk janë kualifikuar drejtpërdrejtë termat e referencës për “Punë të kontraktuara për projekte të ngjashme, ( më gjerësisht shih pretendimet për shkeljet e pretenduara të nenit 59 të LPP- së)

Duke u bazuar në faktet e lartshënuara pretendojmë se AK; Komuna e Podujevës gjatë zhvillimit të procedurës vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit me rastin e përzgjedhjes së pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratës ka vepruar në kundërshtim me piken 41 të rregullave dhe UOPP.

### PERFUNDIM

Duke pasur parasysh këto fakte kërkojmë nga OSHP-se që:

- Të aprovoj ankesën si të bazuar,
- Të anuloj Vendimin e AK-se KK- Podujeve të datës 24.05.2019 mbi dhënien e kontratës për OE NTP “Liria “ për tenderin” Ndërtimi i serave për fermer” në vlerë prej 119,217.00 €
- Të kthejë tenderin në RIVLERESIM,
- Të vlerësojë tenderin në pajtim me kërkesat e përcaktuara në Njoftimin për kontratë dhe në Dosje të tenderit.

**VEMENDJE:** Në mënyrën më të shqetshme të mundshme, në grupin e operatorëve ekonomik “PMC” & “ADRI ZAUN-RRETHOJA” nuk po kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit-OSHP në asnjë mënyrë të na favorizoj neve si konzorcium, por vetëm po kërkojmë të vlerësohen me kujdes shkeljet e bëra nga Komuna e Podujevës të kriterëve të cilat vetë ajo i ka përcaktuar në dosjet e tenderit e ku në të njëjtën kohë ajo vetë i shkelë këto kritere. Vetë grupimi ynë në formë konzorciumi tregon se seriozisht e kemi marrë plotësimin e kriterëve të përcaktuar nga Komuna e Podujevës, në mënyrë që oferta jonë të jetë e përgjegjshme. Ndërsa Komuna e Podujevës duke mos respektuar kriteret të cilat vetë i përcakton, përzgjedhë OE NTP “Liria” fitues të kësaj kontrate që nuk ka të bëjë asgjë me ndërtim të serave. Me një vështrim të thjeshtë të dokumentacionit të NTP “Liria” mundë shihet qartë se operatori në fjalë nuk ka të bëjë asgjë me natyrën e punëve të cilat duhet të kryhen në kuadër të kontratës dhe aktivitetet të cilat kryen ky operator nuk kanë kurrfarë relevante me punën që duhet të bëhet me kontratë

Prandaj ANKESA jonë nuk po bëhet sa për të bërë një akt formal juridik, por mendojmë se duke u bazuar në ligjin e prokurimit publik të Republikës së Kosovës jemi të bindur se me të vërtetë jemi në anën e drejtë, në këtë rast.

Mbetemi me shpresë se Ankesa jonë do të shqyrtohet DREJT.

Faleminderit,

Me nderime,

Konzorciumi

Bedri Sylejmani Drejtori “ PMC ” SH.P.K

Ardian Thaqi : Drejtor NTP “ADRIZAUN-RRETHOJA” Prishtinë



**Procesi i prokurimit:**

Data e njoftimit për kontratë (në Eprokurim): .....	08.03.2019
Lloji i procedurës së aplikuar:.....	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:.....	Kontratë publike kornizë - furnizim
Vlera e parashikuar e kontratës:.....	162.396,32 €
Kriteri për dhënie të kontratës(N.52).....	tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave .....	02.04.2019 koha 13:00
Data e hapjes së ofertave .....	02.04.2019 koha 13:00
Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave .....	15.05.2019
Data e njoftimit mbi vendimin e AK.....	24.05.2019
Data e njoftimit me letrën standarde për tenderuesin e pasuksesshëm.....	24.05.2019
Data e kërkesës për rishqyrtim .....	29.05.2019
Data e vendimit të AK –së lidhur me kërkesën për rishqyrtim .....	31.05.2019

**Kriteret për vlerësim:****6.4. Kërkesat e përshtatshmërisë:**

- OE duhet ti përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të LPPK-së.
- Vërtetimi nga Administrata Tatimore e Kosovës;
- Vërtetimi nga Gjykata kompetente

**Dëshmia e kërkuar dokumentare:**

- Një deklaratë në betim e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formularin në aneksin 2.
- Një vërtetim nga ATK në vendin e themelimit të OE se OE në fjalë nuk është me vonesë në pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit. Vlen për OE fitues;
- Një dokument nga Gjykata kompetente ku dëshmon se OE nuk është i falimentuar apo likuiduar. Vlen për OE fitues

**7.1 & 72 Kërkesat e Përshtatshmërisë profesionale:**

1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në vendin tuaj të



Themelimit 2. Certifikata e numrit fiskal 3. Certifikata e TVSH-së
<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> 1. Certifikata e regjistrimit të biznesit - kopje 2. Certifikata e numrit fiskal - kopje 3. Certifikata e TVSH-së, - kopje
8.1 Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare <b>OE duhet të ofroj dëshmi të mjaftueshme AK se qarkullimi vjetor i OE gjatë tre viteve të fundit ka qenë jo më pak se 320,000.00 € .</b>
<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> <b>Sipas nenit 68 pika 1.5, deklaratat tatimore vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës</b>
9.1 & 9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale Kapaciteti teknik dhe profesional: <b>Projektet e realizuara (të natyrës së ngjashme) në tre vitet e fundit e vërtetuar nga OE, minimumi në vlerë 240,000.00euro Në rast të grupit (konsorciumit), udhëheqësi i grupit duhet të ketë së paku 60% të shumës së kërkuar në punë të ngjashme të realizuara në tre vitet e fundit.</b> <b>OE duhet të ofroj dëshmi se mund të angazhoj staf të mjaftueshëm për realizimin e këtij projekti, minimumi 15 punëtorë.</b> <b>a) një menaxher i projektit të jetë inxhinier i diplomuar ose master i ndërtimtarisë - drejtimi konstruktiv, përvoja e punës 2 vite pas diplomimit</b> <b>Mjetet e punës të domosdoshme për realizimin e punimeve në këtë projekt</b> <i>Dëshmia e kërkuar dokumentare</i> <b>Lista e projekteve të realizuara gjatë periudhës tre vjeçare në të cilat specifikohen të gjitha projektet e realizuara në tre vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë duke saktësuar punët e kryera, shumën e kontratës dhe vendin e kryerjes së punimeve, bashkangjitur referenca ose certifikatë ose raporte të pranimit;</b> <b>Lista me numër të punëtorëve e nënshkruar dhe e vulosur nga OE</b> <b>Për stafin profesional (inxhinierë) - kopja e diplomës e noterizuar, cv-ja, kontrata e punës</b> <b>Nëse inxhinieri nuk është në listën e punëtorëve kërkohet marrëveshje për angazhim në këtë projekt.</b> <b>Lista e pajisjeve - mjeteve të punës që OE duhet të ketë ose të kontraktuara (me qira) të dëshmohet me kopje të librezave apo ndonjë dëshmi tjetër)</b>



**Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:**

Nr	Operatorët Ekonomik	Çmimi € me TVSH	Vërejtje
1.	Zajednica ponuditelja PMC SH.P.K.; N.T.P. Adri Zaun - Rrethoja, Ulpianë, 10000, Pristina	112.565,00	JO
2.	" BERISHA CONSTRUCTION " SH.P.K., Deshmoret e Kombit, 32000, KLINË	125.088,98	JO
3.	N.T.P. " LIRIA ", ZAHIR PAJAZITI 71, -, PODUJEVË	101.031,35	JO
4.	Zajednica ponuditelja Liria SH.P.K.; N.P.T. EURO SERA, Zahir Pajaziti, -, PODUJEVË	114.222,00	JO
5.	N.SH "KASTRIOTI", PRELEZ I JERLIVE, -70000, PRELEZ I JERLIVE	99.903,39	JO

**Komisioni vlerësues pranë AK:**

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje, si në vijim:

- Ismet Kadriu – Kryetar i komisionit
- Musli Kutleshi – Anëtar i komisionit
- Behë Govori – Anëtar i komisionit

**Raporti i komisionit vlerësues:**

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

**Vërejtje përmbyllëse në lidhje me vlerësimin e tenderëve të përgjegjshëm:**

- Komisioni në përbërje të plotë pas vlerësimit dhe egzaminimit të të gjitha dosjeve të tenderit konstatoi se në bazë të kriterëve të kërkuara në DT si çmimi më i lirë OE NTP "Liria" i plotëson të gjitha kriteret dhe si i tillë komisioni rekomandon që ky OE të shpërblehet me kontratë.

**Analiza dhe sqarimet-përgjigje e ekspertit shqyrtues ( Neni 113, 114 ).**

**Tenderuesi Ankues, Grupi i Operatorëve ekonomik "PMC"SH.P.K. & N.T.P. "Adri Zaun- Rrethoja" nga Prishtina, deklaron se nuk pajtohet me vendimin e publikuar nga AK, KOMUNA E PODUJEVËS të datë 06.05.2019. Mendojmë se AK ka bërë gabim gjatë vlerësimit të tenderit.**



Dispozitat e shkelura sipas tenderuesit ankues Grupi i Operatorëve ekonomik "PMC"SH.P.K. & N.T.P. "Adri Zaun- Rrethoja", Ulpianë, 10000, Prishtinë, janë:

Nenit 7, *Barazia në trajtim/Jo diskriminimi*

Neni 56, *Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave*,

Neni 59, *Vlerësimi ekzaminimi dhe krahasimi*,

Neni 60, *Kriteret pre Dhënien e Kontratës*

II-Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik

Neni 41, *Vlerësimi ekzaminimi dhe krahasimi*

Eksperti shqyrtues pas ekzaminimit të tenderit dhe rrjedhës së procedurës së vlerësimit dhe pretendimeve të palës ankuese në ankesë, duke u bazuar ne shkresat e lendes se trajtuar si dhe duke marr parasysh se këto nene të lartë cekura Tenderuesi ankues ne ankesë, andaj sqaron me sa vijon:

#### **Përgjigje në pretendimin e lartë cekur (Neni 7)**

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues, (*Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi*) është i bazuar, sepse me rastin e kontrollimit të Dosjes së tenderit, Njoftimit për Kontratë dhe dokumentacionin të dorëzuar, gjatë procesit të vlerësimit, Autoriteti Kontraktues nuk e ka shpallur fitues tenderuesin e përgjegjshëm me çmim më të lirë në pajtueshmëri me Nenin 60 të LPP,

Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar:

1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

Autoriteti Kontraktues me rastin e shpalljes së Tenderuesit NTP "Liria" fitues për këtë kontratë ka bërë shkelje të nenit 7 të LPP- së në RK, duke favorizuar ofertën e këtij operatori i cili sipas vlerësimit nga ana ime është i papërgjegjshëm dhe duke diskriminuar operatorët tjerë pjesëmarrës në tender. Me këtë rast nuk e ka trajtuar në mënyrë të barabartë tenderuesin Ankues, Grupi i Operatorëve ekonomik "PMC"SH.P.K. & N.T.P. "Adri Zaun-Rrethoja", Ulpianë, 10000, Prishtinë edhe pse ka ofruar tenderin e përgjegjshëm me çmim më të ulët prej 112.565,00 €.

#### **Përgjigje në pretendimin e lartë cekur (Neni 56)**

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues, është i bazuar, sepse duke u bazuar në rrjedhën e këtij aktiviteti të prokurimit të prezantuar në dokumentacionin e Tenderuesit të shpallur fitues, që e kam shqyrtuar, Autoriteti Kontraktues nuk e ka bërë Përzgjedhjen e fituesit për këtë tender në pajtueshmëri me LPP, Nenin 56-*Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave*, Citojmë



paragrafi 1.1 dhe 1.2 të këtij Neni:

Të gjitha kontratat publike do të jepen, sipas procedurave të themeluara për një seleksionim të tillë, dhe përmes:

1.1. së pari, vlerësimi të tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuar në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit sipas paragrafit 2. të nenit 51 të këtij ligji, dhe tenderëve sipas specifikimeve teknike të kërkuara në bazë të nenit 28 të këtij ligji;

1.2. së dyti, vlerësimi tenderëve në përputhshmëri të kriterëve të vendosura në nenin 60 të këtij ligji

Duke u bazuar në nenin (51 Njoftimi i Kriterëve të Përzgjedhjes) Autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar kriteret e përzgjedhjes që i ka caktuar dhe kërkuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, sepse e ka shpallur Tenderuesin NTP "Liria", i cili nuk i ka plotësuar nenet 68 dhe 69 të LPP, Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare (Nr. i Nenit 8.1 & 8.2) dhe Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale (Nr. i Nenit 9.1 & 9.2). Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE të Tenderit (FTD) faqe 12 në DT.

**Përgjigje në pretendimin e lartë cekur (Neni 59- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve)**

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues, është i bazuar, sepse duke u bazuar në rrjedhën e këtij aktiviteti të prokurimit të prezantuar në dokumentacionin që kam shqyrtuar, Autoriteti Kontraktues nuk e ka bërë Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, në pajtim me neni 59 par. 4 të LPP-së, po citoj: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".

- Duke e shpallur fitues tenderin e tenderuesit NTP "Liria" ka vepruar në kundërshtim me neni 59, paragrafin 2, dhe 4 të LPP-se në Republikën e Kosovës, sepse nga kontrollimi i tenderit të këtij tenderuesi kamë konstatuar se nuk e ka plotësuar nenin 68 të LPP, Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare (Nr. i Nenit 8.1 & 8.2) Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE TË TENDERIT (FTD) faqe 12 në Dosje të Tenderit.

Përshkrimi i Nenit	Nr. i Nenit.	Përmirësimet/Ndryshimet e Neneve relevante të Informatave për Tenderuesve	
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	<b>Kapaciteti teknik dhe profesional:</b>  OE duhet të ofroj dëshmi të mjaftueshme AK se qarkullimi vjetor i OE gjatë tre viteve të fundit ka qenë jo më pak se 320,000.00euro.	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i>  Sipas nenit 68 pika 1.5, deklaratat tatimore vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës

Gjatë kontrollimit të tenderit dhe dëshmive të dorëzuara, të tenderuesit NTP "Liria" në tenderin e tij, kamë konstatuar se nuk ka dorëzuar Dëshmia e kërkuar dokumentare, Deklaratat



Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës, ne pajtueshmëri me **nenin 68 pika 1.5, Deklaratat tatimore vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës**, por ka afruar dëshmi mbi Gjendjen e përgjithshme të deklarimeve dhe transaksioneve tjera për vitin 2012 deri me 2018 si dhe Formularët e Deklarimit në TVSH për vitin 2018, por e dhe me to nuk i plotëson, *Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare përkatësisht të dëshmoj se qarkullimi vjetor i OE gjatë tre viteve të fundit ka qenë jo më pak se 320,000.00 euro, sepse nga to shihet se ka qarkullim për tri vitet e fundit vetëm 188,461.10 € ( Viti 2016 = 48,780.30 €, viti 2017 =127,123.29 € dhe viti 2018 = 12,557.50 € ), që nuk e plotësonë qarkullimin e kërkuar financiar, për këtë arsye NTP "Liria" është dashtë të shpallet e papërgjegjshme.*

- Duke e shpallur fitues tenderin e tenderuesit NTP "Liria" ka vepruar në kundërshtim me neni 59 , paragrafin 2, dhe 4 të LPP-se në Republikën e Kosovës, sepse nga kontrollimi i tenderit të këtij tenderuesi kam konstatuar se nuk e ka plotësuar nenin 69 të LPP, *Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale* (Nr. i Nenit 9.1 & 9.2 ). Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE TË TENDERIT (FTD) faqe 12 në Dosje të Tenderit, ( *Projektet e realizuara (të natyrës së ngjashme) në tre vitet e fundit e vërtetuar nga OE, minimumi në vlerë 240,000.00euro* ).

9. AK në Njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit në FDT të dosjes së tenderit në paragrafin; 9.1 & 9.2 ka kërkuar:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	<b>Kapaciteti teknik dhe profesional:</b>  Projektet e realizuara (të natyrës së ngjashme) në tre vitet e fundit e vërtetuar nga OE, minimumi në vlerë 240,000.00euro Në rast të grupit (konsorciumit), udhëheqësi i grupit duhet të ketë së paku 60% të shumës së kërkuar në punë të ngjashme të realizuara në tre vitet e fundit	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare</i> Lista e projekteve të realizuara gjatë periudhës tre vjeçare në të cilat specifikohen të gjitha projektet e realizuara në tre vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë duke saktësuar punët e kryera, shumën e kontratës dhe vendin e kryerjes së punimeve, bashkangjitur referenca ose certifikatë ose raporte të pranimit
		OE duhet të ofroj dëshmi se mund të angazhoj staf të mjaftueshëm për realizimin e këtij projekti, minimumi 15 punëtorë.  a) një menaxher i projektit të jetë inxhinier i diplomuar ose master i ndërtimtarisë - drejtimi konstruktiv, përvoja e punës 2 vite pas diplomimit	Lista me numër të punëtorëve e nënshkruar dhe e vulosur nga OE Për stafin profesional (inxhinierë) - kopja e diplomës e noterizuar, cv-ja, kontrata e punës Nëse inxhinieri nuk është në listën e punëtorëve kërkohet marrëveshje për angazhim në këtë projekt
		Mjetet e punës të domosdoshme për realizimin e punimeve në këtë projekt	Lista e pajisjeve - mjeteve të punës që OE duhet të ketë ose të kontraktuara (me qira) të dëshmohet me kopje të



Gjatë kontrollimit të tenderit dhe dëshmime të dorëzuara, të tenderuesit NTP "Liria" në tenderin e tij, kamë konstatuar se nuk ka dorëzuar *Dëshmi të mjaftueshme të kërkuar dokumentare*, për:

*Projektet e realizuara (të natyrës së ngjashme) në tre vitet e fundit e vërtetuar nga OE, minimumi në vlerë 240,000.00euro Në rast të grupit (konsorciumit), udhëheqësi i grupit duhet të ketë së paku 60% të shumës së kërkuar në punë të ngjashme të realizuara në tre vitet e fundit.*

Dëshmitë e dorëzuara në tender, me rastin e kontrollimit të tenderit të NTP "Liria" të propozuar për kontratë, mbi plotësimin e kërkesës për mundësitë teknike dhe profesionale duke filluar nga *Lista e kontratave të përfunduara me sukses nga firma NTP "Liria"*, në të cilën i ka paraqitur projektet e realizuara por të cilat janë të gjitha furnizime.

Kjo listë nuk i plotëson dëshmitë e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues, sepse është kërkuar që për këto projekte të saktësojë punët e kryera, shumën e kontratës dhe vendin e kryerjes së punimeve, bashkangjitur referenca ose certifikatë ose raporte të pranimit.

<i>Problemi</i>	<i>Si të veprohet</i>	<i>Neni i LPP-së</i>
Lista e kontratave të realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimale të vlerës së përcaktuar.	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtjshëm	69

Andaj oferta e tenderuesit NTP "Liria" është e papërgjegjshme në kuptim të dispozitave të LPP-se dhe si e tillë duhet të eliminohet nga aktiviteti i mëtejshëm i prokurimit.

- Duke e shpallur fitues tenderin e tenderuesit NTP "Liria" ka vepruar në kundërshtim me neni 59 , paragrafin 2, dhe 4 të LPP-se në Republikën e Kosovës, sepse nga kontrollimi i tenderit të këtij tenderuesi kamë konstatuar se nuk e ka plotësuar nenin 69 të LPP, *Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale* (Nr. i Nenit 9.1 & 9.2 ). Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE TË TENDERIT (FTD) faqe 12 në Dosje të Tenderit, *(Mjetet e punës të domosdoshme për realizimin e punimeve në këtë projekt).*

Gjatë kontrollimit të tenderit dhe dëshmime të dorëzuara, të tenderuesit NTP "Liria" në tenderin e tij, kamë konstatuar se nuk ka dorëzuar *Dëshmi të mjaftueshme të kërkuar dokumentare*, për:

#### Kapaciteti teknik dhe profesional

*Mjetet e punës të domosdoshme për realizimin e punimeve në këtë projekt.*

#### Dëshmia e kërkuar dokumentare

*Lista e pajisjeve - mjeteve të punës që OE duhet të ketë ose të kontraktuara (me qira) të dëshmohet me kopje të*



librezave apo ndonjë dëshmi tjetër).

Dëshmitë e dorëzuara në tender, me rastin e kontrollimit të tenderit të NTP "Liria" të propozuar për kontratë, mbi plotësimin e kërkesës për mundësitë teknike dhe profesionale për, *Lista e pajisjeve - mjeteve të punës, nuk i plotëson kërkesat dhe nuk është në përputhshmëri kërkesën në dosjen e tenderit, pasi nuk i ka bashkangjitur kësaj liste kontrata të kontraktuara (me qira) ose të dëshmohet me kopje të librezave apo ndonjë dëshmi tjetër për pronësi.*

Prandaj, në bazë të analizës së dokumentacionit të prezantuar, pretendimet e Tenderuesin Ankues, Grupi i Operatorëve ekonomik "PMC"SH.P.K. & N.T.P. "Adri Zaun- Rrethoja" se Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahاسimi i Tenderëve, nuk është bërë në pajtim me neni 59 par. 4 të LPP-së, po citoj: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit", janë të qëndrueshme.

#### **Përgjigje në pretendimin e lartë cekur (Neni 60, Kriteret për Dhënien e Kontratës)**

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues, se nuk është zbatuar si duhet Neni 60 të LPP-së me rastin e vlerësimit të tenderëve (Kriteret për Dhënien e Kontratës) është i bazuar, sepse nuk është respektuar ky nen ku kërkohet (citojmë) :

LPP ne nenin 60 paragrafi 1.dhe nen paragrafin 1.1 përcakton:

2. *Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose:*  
1.1 *tenderin ë përgjegjshëm me çmimin më të ulët:*

Duke u bazuar ne fakte te prezantuar ne dokumentacionin qe kam shqyrtuar, analizuar dhe krahasuar dhe në atë që u tha më lartë në këtë raport, Autoriteti Kontraktues ka vepruar ne kundërshtim me nenin 60, duke e shpallur tenderuesin e pa përgjegjshëm NTP "Liria" fitues.

#### **Përgjigje në pretendimin e lartë cekur (Neni 41, Vlerësimi ekzaminimi dhe krahasimi - Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik)**

Eksperti shqyrtues, duke u bazuar në rrjedhën e këtij aktiviteti të prokurimit, të prezantuar në dokumentacionin që kam shqyrtuar, Autoriteti Kontraktues nuk e ka bërë Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahاسimi i Tenderëve, në pajtim me neni 59 par. 4 të LPP-së, dhe Neni 41 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik po citoj:

*41.2 Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve do të kryhet nga AK brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara, në veçanti për kontratat e një natyrë komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh. Procesi i vlerësimit të tenderit do të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve dhe jo më vonë se 5 dite pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve.*

*Vlerësimi i ofertave nga autoriteti kontraktues për këtë natyrë të aktivitetit të prokurimit, nuk duhet të*



*jetë më shumë se 30 ditë, ndërsa ky vlerësim i ofertave ka zgjat afër dy muaj, që është plotësisht kundërligjor.*

Se Autoriteti Kontraktues, nuk e ka bërë Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve, në pajtim me nenin 59 par. 4 të LPP-së, dhe Nenit 41, e kemi konstatuar edhe me rastin e publikimit të në njoftimin respektivisht dokumentin B58-Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 24.05.2019, nuk e përcakton qartë fituesin, ku diku fitues është NTP "LIRIA" e diku fitues është kozorciumi "Liria" SHPK & Eurosera, kurse në procesverbalin e hapjes së tenderit dhe në formularin e dorëzimit të tenderit Emri i kompanisë është: N.T.P. " LIRIA ", ZAHIR PAJAZITI 71, -, PODUJEVË, Kosovë.

Duke u bazuar në nenin (nenin 59 par. 4 të LPP-së, dhe Nenit 41) Autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar kriteret të përzgjedhjes që i ka caktuar dhe kërkuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, sepse e ka shpallur Tenderuesin NTP "Liria", i cili nuk i ka plotësuar nenet 66 të LPP, *Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale* (Nr. i Nenit 7.1 & 7.2 ). Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE të Tenderit (FTD) faqe 12 në DT.

- *Operatorët ekonomik duhet ti plotësojnë kërkesat e përshtatshmërisë profesionale*
- *Në mënyrë që të dëshmohet se operatori ekonomik është i përshtatshëm të marrë pjesë në procedurën e prokurimit, operatori ekonomik duhet t'i dorëzojë dokumente dëshmuese*

Andaj, pretendimet e Tenderuesin Ankues, Grupi i Operatorëve ekonomik "PMC"SH.P.K. & N.T.P. "Adri Zaun- Rrethoja" janë të bazuara sepse Tenderuesin NTP "Liria" në tenderin e tij nuk ka dorëzuar dokumentet bazë të *përshtatshmërisë profesionale*:

1. Certifikata e biznesit (kopje)
2. Certifikata e numrit fiskal (kopje)
3. Certifikata e TVSH (kopje)

Sipas udhëzuesit operativ për prokurim publik autoriteti kontraktues e ka të drejtën të ia kërkojë operatorit ekonomik, por një gjë të tillë autoriteti kontraktues nuk e ka bërë.

Pas këtyre argumenteve të prezantuara përmes këtij raporti, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimet e tenderuesit ankues, Grupi i Operatorëve ekonomik "PMC"SH.P.K. & N.T.P. "Adri Zaun- Rrethoja", se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenet 7, 56, 59, dhe 60 LPP, janë të qëndrueshme.

## **Mendimi i ekspertit shqyrtues**

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues, që ankesa e Tenderuesit ankues Grupi i Operatorëve ekonomik "PMC"SH.P.K. & N.T.P. "Adri Zaun- Rrethoja", të aprovohet e bazuar (për arsyen që u cek më lart), njëherësh propozoj që të anulohet Vendimi i Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.